



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/320
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2021

Nr. Dok. 202101385/2

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe trajtimi i personave që trajtohen në I.V.SH.B. Tiranë.*

Drejtuar: **Z. Ulsi MANJA**
Ministër i Drejtësisë

Znj. Ogerta MANASTIRLIU
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Z. Admir ABRIJA
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

Z. Apostol LUCA
Drejtor i Institucionit të Veçantë Shëndetësor i të Burgosurve

TIRANË

Të nderuar,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81/1 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të të Burgosurve (I.V.SH.B.) Tiranë, më datë 26.11.2021, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu, z. Besnik Deda dhe z. Hazbi Selita me detyrë nd/ komisionerë pranë këtij Mekanizmi.

Objektivi kryesor i kësaj vizite monitoruese ishte vlerësimi i kushteve në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të të Burgosurve (I.V.SH.B.) Tiranë, cilësia e trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve brenda tij, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të

Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme. Vizita në këtë institucion u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi.

Shënime paraprake

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të të Burgosurve (I.V.SH.B.) Tiranë, për vitin 2021. Ky institucion ka kapacitet zyrtar për të akomoduar maksimalisht 100 persona. Qendra Spitalore e Burgjeve është i vetmi institucion që garanton trajtim shëndetësor të specializuar për të dënuarit. Shërbimi kryesor në I.V.SH.B. është ai i kujdesit shëndetësor dhe psikologjik, ku zhvillohen biseda në grup, seanca terapeutike për personat me probleme shëndetësore. Rikujtojmë se rikonstruksioni i I.V.SH.B.-së ka përfunduar në muajin mars 2019 dhe nga informacioni i marrë rezulton se gjatë rikonstruksionit janë kryer ndërhyrje jashtë dhe brenda qendrës spitalore, në çdo kat, në çdo pavion (kirurgjia, patologjia, infektivi, psikiatria) dhe në çdo dhomë.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë gjetjet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues u takua me drejtorin e institucionit, z. Apostol Luca, i cili u tregua bashkëpunues në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Gjatë takimit, grupi inspektues kërkoi fillimisht informacion në lidhje me mënyrën e trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve të akomoduar në I.V.SH.B., respektimin e të drejtave ligjore të tyre, si dhe me problematikat e ndeshura gjatë punës. Nga bisedat paraprake, këqyrjen në vend, kontaktin me stafin, bisedat më vete me të paraburgosurit/dënuarit, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacioneve, u konstatua sa më poshtë vijon:

Gjatë këtij inspektimi u konstatua se në institucion trajtoheshin 63 persona, prej të cilëve (23 gra dhe 5 burra me probleme të shëndetit mendor). Nga 63 pacientët 23 janë të paraburgosur, 13 të dënuar dhe 1 siguri e lartë. I.V.SH.B.

Ndonëse I.V.SH.B. Tiranë, nuk është një institucion i posaçëm mjekësor për trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor, aty mbaheshin dhe trajtoheshin 28 persona me probleme të shëndetit mendor, që kanë kryer vepra penale, për të cilat me vendim gjykate u është dhënë masa mjekësore “mjekim i detyruar në një institucion mjekësor” bazuar në nenin 46/2 të Kodit Penal. Në institucion kishte 2 pavijone të cilat shërbenin vetëm për personat me probleme të shëndetit mendor.

Avokati i Popullit vlerëson se I.V.SH.B. Tiranë nuk është institucion mjekësor i posaçëm sikurse parashikohet në aktet e cituara më sipër, por është institucion i ekzekutimit të vendimeve penale.

Mbajtja e këtyre personave në I.V.SH.B. përbën shkelje të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të tyre, pasi vjen në kundërshtim me:

- Nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilit, të sëmuret mendorë nuk mund të diskriminohen për shkak të statusit të tyre si persona me probleme të shëndetit mendor.
- “Mbi Rregullat Evropiane të Burgut”, miratuar nga Këshilli i Evropës (KiE) dhe deleguar për zbatim me rekomandimin Nr.87/3, të Këshillit të Ministrave, të vendeve anëtare, ndërmjet shumë rregullave të këtij dokumenti, në pikën 100.1, përcaktohet se: *“Personat që konstatohen me probleme të shëndetit mendor nuk duhet të mbahen në burg, por duhet të dërgohen sa më shpejtë që të jetë e mundur nga burgjet në vende të përshtatshme për këtë kategori personash”*.
- Nenin 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”*.
- Ligji nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar ku në nenin 28, pika 1 përcaktohet se: *“Institucionet mjekësore të posaçme janë institucione që shërbejnë për trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykata kompetente ka vendosur masën “mjekim i detyruar” në një institucion mjekësor, të të paraburgosurve apo të dënuarve që shfaqin probleme të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave për të cilët gjykata ka vendosur masën mjekësore “shtrimi i përkohshëm” në një institucion të posaçëm në bazë të nenit 239 të Kodit Procedurës Penale”*.
- Theksojmë se ligji nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.06.2012, nuk e kushtëzon zbatimin e dispozitave të tij me ndërtimin apo krijimin e institucioneve mjekësore të posaçme nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale.
- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në datë 21.01.2020 ka dalë me vendimin për çështjen Strazimiri kundër Shqipërisë, në vendimin në fjalë, GJEDNJ ndër të tjera, *“Vëren gjithashtu se ka një dështim të gjatë të autoriteteve shqiptare për ndërtimin e një institucioni mjekësor për trajtimin e personave me sëmundje mendore të cilëve u është kufizuar liria me urdhër gjykatë që kërkon mjekim të detyruar. Shqipërisë i kërkohet nga Gjykata të krijojë institucionet e përshtatshme për këtë problem dhe të sigurohet që ankuesi të marrë psikoterapi dhe jo vetëm ilaçe”*.

Në disa nga vendet anëtare të KiE-së si Gjermania, parashikohet se sistemi i burgjeve është i detyruar ligjërisht të kujdeset për shëndetin fizik dhe mendor të të burgosurve. Për të ofruar kujdes mjekësor sa më të përshtatur për nevojat e pacientit, praktikat e mjekëve mbahen në të gjitha qendrat korrektuese. Infermierët punojnë së bashku me mjekët në këto praktika të cilat ofrojnë kujdes mjekësor parësor si dhe disa kujdes mjekësor të specializuar.

Nëse këto shërbime rezultojnë të pamjaftueshme, të burgosurit mund të trajtohen si pacientë ambulatorë ose të shtruar në Spitalin e Burgut të Berlinit. Ky është një spital me të gjitha shërbimet bazë dhe komoditetet spitalore, dhe gjithsej ka 116 shtretër. Ky spital përfshin departamentin me specialistë psikiatër dhe psikoterapeutik (36 shtretër) dhe mjekësinë interne (80 shtretër), duke përfshirë 20 vende trajtimi për kujdesin e specilaizuar para dhe pas operacionit të patologjive kirurgjikale. Vetëm kur nuk është e mundur të kryhen ekzaminimet dhe programet e nevojshme të trajtimit në këtë institucion, siç është rasti për kujdesin intensiv, operacionet, dializën, kateterët kardiak ose proceset që kërkojnë pajisje të specializuara në shkallë të gjerë, trajtimi transferohet në spitale të tjera ose institucione të tjera mjekësore.¹

Ndërkohë që në Francë të burgosurit, gjendja e shëndetit mendor të të cilëve konsiderohet e papajtueshme me burgosjen, duhet të shtrohen në spital me kërkesë të personelit mjekësor. Në parim, një shtrim i tillë në spital duhet të jetë në njësinë psikiatrike të rezervuar për të burgosurit dhe e vendosur brenda kufijve të një spitali psikiatrik publik. Këto njësi i nënshtrohen rregullave dhe mbikëqyrjes së administratës së burgjeve. Për arsye sigurie, të burgosurit vendosen shpesh në reparte izolimi, në dhoma të mbyllura ku nuk ka mobilje të tjera përveç një dyshek. Kohëzgjatja e qëndrimit është zakonisht vetëm disa ditë, koha e nevojshme për të kaluar periudhën e krizës, pasi spitalet preferojnë të mos i mbajnë të burgosurit, të cilët zakonisht dërgohen përsëri në burg. Disa të burgosur shpesh dërgohen dhe rikthehen nga burgu në spital disa herë për shkak të gjendjes së tyre të dobët shëndetësore. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në një njësi të specializuar është dy ose tre muaj.²

Në sistemin penitenciar në Itali parashikohet se shërbimi mjekësor dhe shërbimi farmaceutik duhet t'i përgjigjet nevojave profilaktike dhe shëndetësore të të burgosurve duke parashikuar të paktën një specialist psikiatër, mundësinë e transferimit në spitalet civile ose qendra të tjera të trajtimit të jashtëm për të dënuarit dhe të paraburgosurit që kërkojnë trajtim ose teste diagnostikuese që nuk mund të kryhen në institucion, si dhe bashkëpunimin e administratës së burgut me punonjës të shëndetit publik lokal, spitalor dhe jashtëspitalor, në marrëveshje me qarkun dhe sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë.³

Në vijim të inspektimit, grupi i punës i kushtoi një vëmendje të veçantë masave të marra për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në I.V.SH.B. Në hyrje të këtij institucioni, kryhej procedura për matjen e temperaturës me termometër digjital për të gjithë personelin dhe personat që hynin për takime me të paraburgosurit apo sillnin pako me ushqime dhe veshmbathje sipas nevojave.

¹ Për më shumë konsulto: [The Prison System - Berlin.de](http://www.prisonobservatory.org/upload/PrisonconditionsinFrance.pdf)

² Për më shumë konsulto: Prisons Conditions in France. European Prison Observatory. Detention conditions in the European Union <http://www.prisonobservatory.org/upload/PrisonconditionsinFrance.pdf>

³ Për më shumë konsulto: Ministria e Drejtësisë, "Diritti dei detenuti" https://www.giustizia.it/giustizia/it/mg_2_3_0_7.page#

Personeli i institucionit, zbatonte me korrektesë masat mbrojtëse dhe dezinfektuese, në ambientet e punës me mbajtjen e maskave, duke ruajtur distancimin fizik dhe social, si dhe në mbajtjen e higjienës personale.

Urdhrat, udhëzimet dhe protokollet shtesë të Ministrisë së Shëndetësisë, ishin të afishuar në hyrje të institucionit, zyrat e administratës dhe në hyrje të pavijoneve. Ishte siguruar bashkëpunimi me Spitalin Infektiv pranë QSUT, të cilët kanë ofruar trajnim nga stafi i specializuar i Shërbimit Infektiv. Trajnimi ishte zhvilluar në ambientet e I.V.B.SH., mbi përdorimin e masave mbrojtëse specifike për mbrojtjen e stafit që shërben në pjesën e spitalit të përshtatur si pavijon COVID. Ekipi multidisiplinar, stafi mjek, infermier, policë, sanitarë janë udhëzuar për raportimin në kohë për praninë e shenjave të sëmundjes COVID-19 tek ata apo familjarët e tyre me qëllim minimizimin e mundësive për përhapjen e këtij infeksioni.

Sipas Urdhrit të Ministres së Drejtësisë, për përshtatjen e ambienteve të spitalit për pacientët me Covid-19, është riorganizuar struktura e brendshme e I.V.SH.B.-së, duke përshtatur pavionin e Patologjisë në funksion të pacientëve me Covid-19, duke bërë mbylljen nga ambientet e tjera të spitalit. Në këtë institucion ishte hapur një derë e re për hyrje/daljet e stafit dhe pacientëve të infektuar. Pavijoni i Covid-19 kishte kapacitet prej 17 shtretër, që janë pajisur me aparate oksigjeni dhe të përshtatura sipas kushteve të spitalit për këtë kategori pacientësh.

Pavijoni i Psikiatrisë është përshtatur si karantinë për çdo pacient, që nuk është i diagnostikuar me COVID-19 por vjen për hospitalizim nga burgjet e tjera me diagnoza të ndryshme, gjatë kësaj periudhe, duke respektuar karantinimin prej 14 ditësh.

Nisur nga informacioni i Drejtorit të institucionit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm⁴, rezultoi se:

- Nuk ishte gjetur zgjidhja përfundimtare për sistemimin e menjëhershëm të personave me probleme të shëndetit mendor, që trajtohen në I.V.SH.B. Tiranë në kundërshtim me ligjin, në pavijone psikiatrike që administrohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, deri në ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore sipas përcaktimit të ligjit të ri nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” i ndryshuar.
- Nuk ishin marrë masat për krijimin e dhomës së kufizimit fizik, dhe po ashtu mungonin krevati fiksues dhe mjetet shtrënguese, të parashikuara me ligjin nr. 44/2012, dt. 01.06.2012. “Për Shëndetin Mendor” i ndryshuar.
- Nuk ishin marrë masat për pajisjen e dhomave të pacientëve me zilet elektronike, çka përbënte pengesë për komunikimin e pacientëve me stafin në rastin e nevojave emergjente për ndihmë nga ana e tyre. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 237, datë 6.3.2009, “Për përcaktimin e kritereve për hapjen dhe mbylljen e spitaleve”, i ndryshuar, parashikon përkatësisht se “Dhoma e infermieres, e cila duhet të jetë pranë

⁴ Rekomandimi i dërguar me shkresën nr. K4/I46-2 prot., datë 25.05.2021. Përgjigjia e Ministrisë së Drejtësisë me nr. 2805/1 prot., datë 30.07.2021.

dhomave të pacientëve, të jetë e pajisur me lavaman, me vend ku përgatitet mjekimi, si dhe me një sistem-thirrës që të bëhet lidhja me çdo dhomë pacienti.”⁵. Duket qartë se ky parashikim nuk është respektuar gjatë ndërtimit të këtij institucioni gjë që përbën shkelje të kriterëve të ndërtimit.

- Nuk ishin marrë masat për plotësimin e nevojave të parburgosurve dhe të dënuarve për blerje të artikujve të ndryshëm në mungesë të dyqanit dhe të arkës në institucion.

Ndërkohë, nuk kishte gjetur zbatim dhe nuk ishte plotësuar një nga rekomandimet e Avokatit të Popullit. Më konkretisht:

- sistemi i ngrohjes ishte funksional, pasi kaldajat ishin vënë në punë.

Organika në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të të Burgosurve (I.V.SH.B.) Tiranë përbëhej 63 punonjësish nga të cilët 46 punonjës në sektorin shëndetësor, 3 punonjës në sektorin e çështjeve shoqërore, sektori i shërbimit ligjor 2 punonjës, stafi i sigurisë përbëhej prej 77 punonjës.

Sa i përket funksionimit të shërbimit shëndetësor, u konstatua se stafi mjekësor përpiquej të ofronte një shërbim sa më të kujdesshëm dhe të plotë. **Organika e stafit shëndetësor** përbëhej me 10 mjekë me kohë të plotë e 1 mjek kardiolog me kohë të pjesshme, 1 kryeinfermier, 18 infermierë nga të cilët kishte 2 vende vakante, 1 laborant, dhe 5 kujdestarë nga të cilët kishte 2 vende vakante. Nga bisedat me stafin dhe nga shqyrtimi i dokumentacioneve u konstatua se:

Sa i përket funksionimit të sektorit të çështjeve shoqërore, u konstatua se organika e sektorit ishte e plotësuar me staf dhe përbëhej nga dy specialiste edukimi, përkatësisht një psikologe që mbulonte me shërbim pacientët me mjekim të detyruar, një punonjëse sociale për shtrimet e përkohshme, dhe nga përgjegjësjë e sektorit me formim psikologe e cila mbulonte rastet e tjera.

Nga bisedat me stafin dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- Janë zhvilluar aktivitete kulturore-fetare dhe organizim ditëlindjesh në bashkëpunim me Shoqërinë Kristiane të të Burgosurve Shqiptar, Komitetin Mysliman Shqiptar për iftar si dhe me Arkidieqzën Metropolitane Tiranë-Durrës bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit.
- Nuk kishte organikë punësimi nga të akomoduarit pranë I.V.Sh.B. për shkak të specifikës së institucionit.
- Nga ana e stafit bëheshin përpjekje për realizimin e këshillimeve individuale 1 herë në muaj me secilin pacient, të cilat ofroheshin në dhomën e këshillimit, sipas planit të punës ose kërkesave nga vetë pacientët. Këshillimi individual 1 herë në muaj është i pamjaftueshëm për arritjen e qëllimit të rehabilitimit.

⁵ Pika 8 e Aneksit I “Kriteret e Ndërtimit” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 237, datë 6.3.2009 “Për përcaktimin e kriterëve për hapjen dhe mbylljen e spitaleve”, i ndryshuar.

- Në ambientin e ajrosjes për gra dhe në dhomën e këshillimit të burrave trajtoheshin në grupe të vogla tema sociale mbi tematika aktuale.
- Dosjet psiko-sociale, në të cilat ishin të përfshira programet individuale të trajtimit mbaheshin përgjithësisht me rregull dhe të mbyllura me çelës, megjithëse plotësimet e shumë prej tyre ishin formale. Planet individuale të trajtimit ishin kryesisht të përqendruara në personat me varësi nga substancat narkotike.
- Punonjësit e këtij sektori ishin prezentë në vizitat e mëngjesit, që bënte stafi mjekësor në pavione, planet e ndërhyrjes nga ana e stafit psiko-social, sidomos në rastet me probleme të shëndetit mendor.

Sipas informacionit nga drejtuesit e institucionit dhe bazuar në Urdhrin nr. 372, datë 11.6.2021 *“Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19, në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”*⁶ i ndryshuar, të Ministrit të Drejtësisë, krahas masave lehtësuese, takimet fizike me familjarët vijonin të ishin të njëjta, 1 (një) herë në muaj, duke garantuar higjienën e nevojshme, kontrollin shëndetësor gjatë hyrjes, kontrollin e pasjes nga ana e vizitorit të vërtetimit nga autoritetet shëndetësore përkatëse ose analizës/dëshmisë serologjike mbi shërimin rishtazi nga COVID-19, testit të vlefshëm negativ nga infektimi me infeksionin e shkaktuar nga COVID-19 ose vërtetimit/dëshmisë së vaksinimit të plotë, ndërkohë që vijonte komunikimi online nëpërmjet platformës Skype, 4 herë muaj.

Nga kontakti që patëm me pacientët, pa praninë e stafit, nuk rezultoi, që ndaj tyre të ishte ushtruar presion psikologjik apo forcë fizike tej kufijve.

Nga verifikimi i regjistrave të kërkesë/ankesave rezultoi se prej muajit janar deri në muajin nëntor 2021, kishte 85 kërkesa, të cilat konsistonin në kërkesa për takim me drejtorin, komunikim me familjarët nëpërmjet platformës “Skype”, kërkesa për tv etj.

Në aspektin e trajtimit ushqimor kuzhina shërbente vetëm për shpërndarjen në pavijone gjatë vakteve të ushqimit që sigurohej me catering nga kuzhina e Q.S.U.T-së duke mbuluar edhe nevojat për ushqim të pacientëve diabetikë.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 datë. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” ku parashikohet midis të tjerash se: “2. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca:*

⁶ <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2021/06/11/372/79df36b8-05e3-4cc7-a5ad-54ab7a6b9dee>

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për sistemimin e menjëhershëm të personave me probleme të shëndetit mendor, që trajtohen në I.V.SH.B. Tiranë në kundërshtim me ligjin, në pavijone psikiatrike që administrohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, deri në ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore sipas përcaktimit të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar.
2. Marrjen e masave për krijimin e një dhome kufizimi fizik, e cila duhet të vihet në funksion sipas kriterëve të mirë përcaktuara në nenin 27 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, duke qenë se ky institucion trajton edhe persona me probleme të shëndetit mendor.
3. Marrjen e masave për pajisjen e çdo dhome të regjimit të brendshëm me zile elektronike, në mënyrë që të lehtësohet komunikimi i pacientëve me stafin në rastin e nevojave emergjente për ndihmë nga ana e tyre, çka është konstatuar nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, se nuk janë përmbushur standardet e kriterëve të ndërtimit siç parashikohet në legjislacionin në fuqi, përkatësisht në pikën 8 të Aneksit I “Kriteret e Ndërtimit” të V.K.M. nr. 237, datë 6.3.2009 “Për përcaktimin e kriterëve për hapjen dhe mbylljen e spitaleve”, i ndryshuar.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës me 1 (një) mjek kardiolog me kohë të plotë, 2 (dy) infermierë dhe 2 (dy) kujdestarë.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për shtimin e këshillimeve individuale më shumë se 1 herë në muaj me secilin pacient, pasi këshillimi individual 1 herë në muaj nuk e arrin qëllimin e rehabilitimit.
6. Marrjen e masave për vënien në shërbim të pacientëve të një dyqani brenda institucionit, në mënyrë që pacientët të kenë mundësi të sigurojnë produktet bazë jetike.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANCA

Konc.: G. Çarkaxhiu